

**UDHËZIM****Nr. 1917, datë 1.9.2014****PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHËRBITIMIT PËR KALIMIN ME AVION
TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZOJNË:

1. Tarifat e shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, është 10 euro dhe paguhet nga udhëtari në momentin e blerjes së biletës, tek shoqëritë ajrore, pavarësisht vendit apo mënyrës së shitjes së biletës.

2. Tarifa e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë është një pagesë e detyrueshme që bëhet për llogari të buxhetit të shtetit nga çdo udhëtar që del nga territori i Republikës së Shqipërisë në drejtim të destinacioneve jashtë, përveç rastit kur udhëtari është transit dhe nuk e kalon kufirin, por qëndron në ambientet e aeroportit deri në vazhdimin e udhëtimit të tij.

3. Shoqëria “Tirana International Airport” (TIA) caktohet agent për mbledhjen e tarifës të kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Të kryejë, në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit dhe këtij udhëzimi, të gjitha procedurat për regjistrimin e kësaj tarife në sistemin e IATA-s.

b) Të llogarisë shumën që do të paguhet nga ana e shoqërive ajrore, mbështetur në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve.

c) Të rakordojë brenda datës 5 të muajit pasardhës me shoqëritë ajrore, për tarifën e paguar pranë këtyre shoqërive, nga pasagjerët udhëtues në muajin paraardhës. Në rast mosrakordimi, për çfarëdolloj arsyeje, atëherë rakordimi do të merret i mirëqenë dhe do të konsiderohet i bërë me lëshimin e faturës nga TIA, në formë elektronike për shoqëritë ajrore.

d) T’u faturojë shoqërive ajrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bazuar në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve për muajin paraardhës, dhe

aktin e rakordimit të mbajtur me shoqëritë ajrore, shumën për t’u paguar nga këto shoqëri në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TIA.

Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit të pasagjerëve dhe këto dokumente ruhen në TIA dhe në shoqërinë ajrore. Faturimet u dërgohen shoqërive ajrore me rrugë elektronike dhe me postë.

e) Mbi bazën e faturimeve të bëra, të kërkojë nga shoqëritë ajrore likuidimin e shumave të faturuara brenda datës 15 të muajit pasardhës.

f) Në rast moslikuidimi nga shoqëritë ajrore brenda datës 15 të muajit pasardhës të shumave të faturuara, TIA dërgon një njoftim të dytë në rrugë elektronike ose me postë shoqërive ajrore ku kërkon likuidimin e menjëhershëm të shumave mbi bazën e faturimeve të bëra dhe nëse edhe mbas këtij njoftimi nuk bëhet likuidimi nga shoqëritë ajrore, TIA evidenton shumat e faturuara dhe të likuiduara për efekt të plotësimit të formularit të deklarimit.

g) Të deklarojë dhe transferojë sipas aneksit (formulari i deklarimit) të këtij udhëzimi, në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar, brenda datës 15 të muajit pasardhës shumat e arkëtuara nga shoqëritë ajrore.

h) Të evidentojë shumat e faturuara dhe të arkëtuara nga tarifa e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, si dhe detyrimet e paarkëtuara.

4. Shoqëritë ajrore, të cilat kanë përgjegjësinë që të arkëtojnë nëpërmjet shitjes së biletës tarifën e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe të transferojnë shumat e arkëtuara te TIA, ngarkohen me detyrat e mëposhtme:

a) Pas kryerjes nga TIA, në përputhje me germën “a”, të pikës 3, të këtij udhëzimi, të regjistrimit në sistemin e IATA-s të tarifës, çdo shoqëri ajrore në momentin e shitjes së biletave, duhet t’i shtojë këtë tarifë vlerës së biletës, si dhe ta pasqyrojë në të vlerën e tarifës të kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

b) Të arkëtojnë tarifën e paguar nga udhëtarët, nëpërmjet shitjes së biletave.

c) Të rakordojnë me TIA-n për tarifën e arkëtuar dhe të transferojnë për llogari të TIA-s shumat e arkëtuara, në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë udhëzim.

d) Të mbajnë dokumentacionin përkatës për



numrin e biletave të shitura, numrin e biletave të anuluar dhe shumat e kthyer paguesve të tarifës.

Degët, apo zyrat e përfaqësimit në Shqipëri të shoqërive ajrore të huaja, janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me këtë udhëzim në përputhje me tagrin e dhënë në përfaqësim.

5. Mbi tarifat e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH.

6. Për shërbimin e kryer, TIA mban 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe transferon në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 95% të shumës së arkëtuar.

7. Për mosrespektim nga TIA të detyrimeve të përcaktuara në dispozitën 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g” të këtij udhëzimi, zbatohen sanksione në përputhje me nenin 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. Për mosrespektim, nga degët e shoqërive të huaja ajrore në Shqipëri, si dhe nga shoqëritë ajrore vendase, të detyrimeve të përcaktuara në dispozitën 4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” për këto subjekte zbatohen sanksione në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

9. Formulari i paraqitur në aneksin bashkëlidhur, do të jetë në fuqi deri në informatizimin e sistemit të tarifave dhe unifikimin e formularit të deklarimit.

10. Ky udhëzim shfuqizon udhëzimin nr. 40, datë 24.12.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRI I FINANCËVE
Shkëlqim Cani



ANEKS

Formulari i deklarimit

TARIFA PËR KALIMIN ME AVION TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS, SË SHQIPËRISË

Deklarim për agjentin TIA

1. Shoqëri ajrore të huaja rezidente
2. Shoqëri ajrore të huaja jo rezidente
3. Shoqëri ajrore vendase

Faturime	Shume tarifës

TOTALI

Administratori:
(emër, mbiemër)
nënshkrimi